

UDHËZIM
Nr. 47, datë 2.11.2015

PËR PROCEDURAT E PRANIMIT DHE REGJISTRIMIT PËR KANDIDATËT NGA REPUBLIKA E KOSOVËS, SI DHE KANDIDATËT SHQIPTARË NGA MAQEDONIA, MALI I ZI, PRESHEVA, BUJANOVCI DHE MEDVEGJA, NË CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË, “MASTER PROFESIONAL” DHE “MASTER I SHKENCAVE”/“MASTER I ARTEVE TË BUKURA”, NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK 2015–2016

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 34 dhe 75, të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, nenit 135, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; vendimit nr. 638, datë 22.7.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat e pranimit dhe tarifat e studimit, në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2015 – 2016”, të ndryshuar, dhe vendimit nr. 1013, datë 10.12.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP)”,

UDHËZOJ:

1. Kandidatët nga Republika e Kosovës, si dhe kandidatët shqiptarë nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, aplikojnë pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS), nga data 2 deri në 9 nëntor 2015, në zbatim të vendimit nr. 638, datë 22.7.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat e pranimit dhe tarifat e studimit, në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2015–2016”, të ndryshuar. Kandidatët shprehin 5 referenca të ndryshme, lidhur me aplikimin në programet e preferuara të studimit sipas formularit në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Kandidatët nga Republika e Kosovës, si dhe kandidatët shqiptarë nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, në momentin e aplikimit duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm në dy kopje të njësuara me origjinalin.

a) Formulari i aplikimit, sipas formatit të shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi. Në formular duhen radhitur pesë programe studimi ku kandidati kërkon të aplikojë, si dhe institucioni i arsimit të lartë (IAL) përkatës, në renditje prioritare, pra i pari renditet programi më i preferuar dhe i fundit ai më pak i preferuar nga të pesta programet. Për emërtimin dhe ID-në e programit përkatës u duhet referuar tabelave nr. 1/1 dhe 2/2, të vendimit nr. 638, datë 22.7.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat e pranimit dhe tarifat e studimit, në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2015–2016”, i ndryshuar.

Diploma universitare e ciklit të parë të studimeve të përfunduar brenda Republikës së Shqipërisë, së bashku me suplementin e diplomës ose listën e notave. Në mungesë të diplomës, IAL-të publike pajisin kandidatin me një vërtetim që provon mbarimin e studimeve konform ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe lejon regjistrimin në ciklin e dytë të studimeve. Kandidati paraqet vërtetim në IAL-në ku kërkon të regjistrohet sipas afateve të parashikuara në këtë udhëzim, dhe brenda 6 muajve dorëzon fotokopjen e njëzuar me origjinalin të kartonit të diplomës të lëshuar nga IAL-ja përkatëse.

Për diplomën universitare të ciklit të parë të fituar jashtë vendit, të depozitohet dhe vërtetimi i njohjes dhe njësimit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Për kandidatët të cilët nuk kanë njohur dhe njëzuar diplomat e tyre të fituara jashtë vendit, depozitojnë dokumentacionin për njohje diplome në të njëjtën ditë me aplikimin.

b) Diplomën/dëftesën e shkollës së mesme të fituar në vendin përkatës, me certifikatën e notave, të njohura nga komisioni i posaçëm për njohjen e diplomave të shkollës së mesme në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit. Për kandidatët të cilët nuk kanë njohur dhe njësuar diplomat e tyre të fituara jashtë vendit, depozitojnë dokumentacionin për njohje diplome të shkollës së mesme së bashku me aplikimin.

c) Dokument identifikimi (kartë identiteti, pasaportë). Në dosje mbahet vetëm fotokopja e dokumentit të identifikimit.

d) Dy fotografi personale.

e) Mandatarkëtimi i tarifës së aplikimit prej 2,000 lekësh paguar pranë zyra të Postës Shqiptare, për llogari të IAL-së përfituese.

Një kopje e dokumentacionit të depozituar ruhet në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit. Aplikimet me dokumentacion të paplotë nuk merren në konsideratë.

3. Përzgjedhja e kandidatëve bëhet nga një komision i posaçëm, i ngritur me urdhër të ministrit të Arsimit dhe Sportit. Vlerësimi të bëhet mbi kriterin e meritës, bazuar në notën mesatare të të gjitha viteve të studimeve universitare të ciklit të parë dhe në notën mesatare të të gjitha viteve të shkollës së mesme, duke vlerësuar dhe programet që gjykohet të jenë prioritare sipas propozimeve të autoriteteve të vendeve përkatëse, si dhe duke marrë parasysh kapacitete pritëse të çdo IAL-je për programin përkatës të studimit. Nëse do të rezultojnë

kandidatë me pikë të barabarta do t'i nënshtrohen testimit që do të kryhet nga MAS-i.

4. Brenda datës 16 nëntor 2015, MAS-i përcjell në IAL-të respektive listën e renditur të kandidatëve të përzgjedhur sipas procedurës së mësipërme dhe një kopje të dokumentacionit të dorëzuar nga kandidati, për të vijuar me regjistrimin e kandidatëve në programet përkatëse të studimit. MAS-i publikon në faqen *web* listën e kandidatëve dhe afatet e regjistrimit të tyre në IAL-të përkatës.

5. Kandidatët nga Republika e Kosovës, si dhe kandidatët shqiptarë nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, të cilët rezultojnë fitues, regjistrohen pranë sekretarive mësimore të fakulteteve nga data 16 deri në datën 20 nëntor 2015.

6. Me mbylljen e regjistrimit përfundimtar, institucionet publike të arsimit të lartë të dorëzojnë në AKP, brenda datës 25 nëntor 2015, listat përfundimtare të përgatitura sipas formatit të dërguar nga AKP-ja, me regjistrimet e kryera për çdo program studimi të ciklit të dytë me kohë të plotë, për dhënien e numrave të matrikullimit, në formë të shkruar dhe elektronike.

7. AKP-ja, brenda datës 28 dhjetor 2015, i dërgon IAL-ve publike në rrugë postare, listën me numrat e matrikullimit të studentëve. IAL-të publike çregjistrojnë studentët e papajisur me numër matrikullimi dhe ia komunikojnë çregjistrimin AKP-së brenda 10 ditëve nga marrja e komunikimit zyrtar nga AKP-ja me listat me numrat e matrikullimit.

8. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Arsimit të Lartë dhe Shkencës në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Komisioni i Posaçëm, Agjencia Kombëtare e Provimeve, si dhe institucionet publike të arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla

Formular aplikimi

Unë i nënshkruari _____, lindur më _____
emri atësia mbiemri

me kartë identiteti/pasaportë nr. _____

e-mail: _____, Tel: _____

1. Kërkoj të regjistrohem në programin e studimit:
 - a. _____, ID _____, në IAL _____, ose
 - b. _____, ID _____, në IAL _____, ose
 - c. _____, ID _____, në IAL _____, ose
 - d. _____, ID _____, në IAL _____, ose
 - e. _____, ID _____, në IAL _____.
2. Deklaroj se aplikoj me kuotat për kandidatët me kombësi shqiptare nga trojet (të shenohet me "x" vendi nga vjen kandidati):
 - ☐ Republika e Kosovës;
 - ☐ Mal i zi;
 - ☐ Maqedoni;
 - ☐ Preshevë;
 - ☐ Bujanovc;
 - ☐ Medvegjë;
3. Autorizoj institucionet e arsimit të lartë të sipërcituara, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Agjencinë Kombëtare të Provimeve për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në Institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin e tyre.
Autorizoj, gjithashtu Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Agjencinë Kombëtare të Provimeve për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me: studimet universitare ku kam aplikuar për t'u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë, dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër, aplikimin, si dhe të dhënat e deklaruara në këtë formular.
4. Deklaroj se nuk kam aplikuar për t'u regjistruar në asnjë institucion tjetër të arsimit të lartë, për vitin akademik 2015-2016.
5. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.
6. Deklaroj se jam njohur me Udhëzimin përkatës dhe jam i qartë për procedurat e aplikimit, përzgjedhjes dhe regjistrimit.
7. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitur. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumentave të falsifikuar apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe/ose Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

Emër Atësi Mbiemër
i kandidatit

Emër Mbiemër
i punonjësit që pranoi aplikimin

Firma

Firma